

VENDIM
Nr. 845, datë 28.10.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ZHVILLIMIN E
AKTIVITETEVE TURISTIKE DETARE, QË KRYHEN NËPËRMJET MJETEVE
LUNDRUESE PËR QËLLIME TURISTIKE DHE ARGËTIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi në vijën bregdetare, hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Aktivitetet turistike detare, që përfshihen në këtë rregullore janë:

- a) lundrimi për zbavitje;
- b) peshkimi nën ujë;
- c) zhytja çlodhëse;
- ç) *kitesurfing*;
- d) *windsurf*;
- dh) *wakeboard*;
- e) lundrim me motor uji;
- ë) *rafting*, *kayake* dhe kanoe.

3. Shtojca A-2 e çdo dispozitë tjetër e vendimit nr. 321, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, të ndryshuar, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, inspektorati që mbulon fushën e turizmit dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLAT E HOLLËSISHME
PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TURISTIKE DETARE

I. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË LUNDRIMIT PËR ZBAVITJE

1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për ushtrimin e aktivitetit të lundrimit për zbavitje me mjete lundruese turistike nga operatorët e turizmit detar, që mund të jenë persona fizikë apo juridikë, vendës e të huaj, të licencuar si “Operator turistik”, me kodin XIII.1.B, dhe të certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, në vijim, operator i turizmit detar, si dhe nga individët vendës e të huaj, që lundrojnë në vijën bregdetare, në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, për qëllime turistike dhe argëtim, private apo tregtare përkundrejt një kontrate qiraje me/pa ekuipazh, përfshirë dhe ofrimin e shërbimeve të akomodimit, pijeve dhe të ushqimit për klientët në bord.

2. Mjetet lundruese turistike konsiderohen se përdoren për qëllime tregtare, në këto raste:
 - a) kur kryejnë lundrime turistike me pasagjerë nga një port në një destinacion turistik për qëllime argëtimi;
 - b) kur janë objekt i kontratave të qirasë;
 - c) kur përdoren për trajnime profesionale të drejtimit e manovrave;
 - ç) kur përdoren si njësi mbështetëse dhe siguroese e zhytësve.
3. Dhënia me qira e jahteve apo e mjeteve të tjera të vogla lundruese jepet në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për aktivitetet e turizmit detar nga operatori i turizmit detar.
4. Operatori i turizmit detar, në rastin kur jahtin ose mjetin e vogël lundruar e jep me qira apo në përdorim në një nga format e kontratave të çartërimit “Bareboat” apo “Çarter me kohë”, detyrohet të njoftojë pranë kapitenarisë së portit përkatës (Zyrës së Regjistrimit të Mjeteve Lundruese Shqiptare) për aktin e dhënies me qira të mjetit, duke e dërguar me *email* ose duke ngarkuar në sistemin elektronik një kopje të kontratës.
5. Aktiviteti i lundrimit për zbavitje mund të kryhet nga një operator i turizmit detar, me:
 - a) një mjet lundruar me flamur shqiptar;
 - b) një mjet lundruar me flamur të huaj për të cilin është marrë licenca për transport kombëtar, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Operatori i turizmit detar që ushtron lundrimin turistik është i detyruar:
 - a) të ushtrojë aktivitetin e tij në vende të lejuara, sipas zonave të publikuara nga ministria përgjegjëse për turizmin;
 - b) të marrë përsipër zbatimin e Kodit të Etikës, miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, nëpërmjet nënshkrimit të një vetëdeklarimi;
 - c) të disponojë pajisje për regjistrimin elektronik të listës së ekuipazhit dhe të pasagjerëve, që përfshin lidhjen në internet;
 - ç) të raportojë listën e ekuipazhit e të pasagjerëve para çdo udhëtimi në sistemin elektronik, sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
 - d) t'i dorëzojë klientit mjetin lundruar, sipas parashikimeve të kontratës së qirasë.
7. Mjeti lundruar, sipas pikës 3, të këtij kreu, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - a) të jetë i regjistruar për qëllime tregtare (ekonomike);
 - b) të jetë teknikisht i përshtatshëm për kryerjen e veprimtarive të lundrimit për zbavitje në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;
 - c) të ketë një numër minimal të anëtarëve të ekuipazhit me kompetencë profesionale të përshtatshme;
 - ç) të posedojë të gjitha dokumentet në bord, në përputhje me legjislacionin;
 - d) të ketë një policë sigurimi të përgjegjës ndaj palëve të treta që mbulon ngjarjet e dëmshme në ujërat e detit të brendshëm e të detit territorial të Republikës së Shqipërisë;
 - dh) për mjetet mbi 12 (dymbëdhjetë) pasagjerë, të ketë paraprakisht raportin e inspektimit nga Kontrolli Shtetëror i Flamurit.
8. Përveç kushteve, sipas pikës 7 të këtij kreu, një anije me flamur të huaj nuk duhet të ketë tejkalar afatin prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh që nga njoftimi në hyrje i Kapitenarisë së Porteve për përdorimin e regjimit të përkohshëm.
9. Nëse në vendin e përkatësisë nuk është i parashikuar detyrimi për të regjistruar qëllimin e një mjeti lundruar, për mjete lundruese me të njëjtat karakteristika teknike të zbatohen parashikimet e pikës 7 të këtij kreu.
10. Kontrata e qirasë së mjetit lundruar turistik është kontrata me të cilën njëra prej palëve detyrohet të japë në përdorim mjetin, për qëllime turistike (argëtimi), për një periudhë të caktuar kohore. Këto kontrata lidhen vetëm kur njëra nga palët është operator turistik detar i licencuar me licencën me kodin XIII.1.B si “Operator turistik” dhe i certifikuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetet e turizmit detar.
11. Kontratat e qirasë janë:

a) kontrata “Bareboat”, sipas së cilës njëra nga palët merr përsipër t’i dorëzojë palës tjetër mjetin lundruar për një periudhë të caktuar kohe, kundrejt pagesës së një tarife, pa ekuipazh. Kjo kontratë hartohet me shkrim, nënshkruhet nga palët e kopja origjinale ose një kopje e njësuar me origjinalin mbahet në bord;

b) kontrata “Çarter me kohë”, me të cilën njëra palë merr përsipër të vërë në dispozicion të palës tjetër mjetin lundruar për një periudhë të caktuar kohore, kundrejt një pagese të caktuar, përfshirë kapitenin e ekuipazhin. Kjo kontratë hartohet me shkrim dhe kopja origjinale ose një kopje e njësuar me origjinalin mbahet në bord.

12. Dorëzimi i mjetit të lundrimit të klienti apo drejtuesi, sipas shkronjës “d”, të pikës 6, të këtij kreu, duhet të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:

a) ruajtjen në bord të të gjitha dokumenteve të mjetit sipas llojit, të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi;

b) ruajtjen në bord të dokumentacionit të drejtuesit të mjetit, i cili vërteton aftësinë profesionale të tij;

c) pajisjen e mjetit lundruar me pajisjet e shpëtimit të jetës në det;

ç) pajisjen e mjetit lundruar me pajisjet e luftës kundër zjarrit;

d) pajisjen e mjetit lundruar me pajisjet e komunikimit e të vendndodhjes;

dh) përveç sa është parashikuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë akt, ruajtjen në bord të dokumenteve të mëposhtme:

i. dëshmisë së aftësisë së lundrimit të mjetit;

ii. certifikatës së mjetit;

iii. dëshmisë së kualifikimit të drejtuesit të mjetit lundruar për drejtimin e saj në përputhje me legjislacionin e shtetit të flamurit;

iv. policës së sigurimit për përgjegjësinë ndaj dëmeve të shkaktuara ndaj palëve të treta;

v. listës së ekuipazhit e të pasagjerëve;

vi. procesverbalit të dorëzimit të anijes.

13. Procesverbali për procedurën e dorëzimit hartohet e nënshkruhet nga personi përgjegjës i operatorit të turizmit detar që ka kryer dorëzimin dhe drejtuesi i mjetit lundruar.

14. Procesverbali, sipas pikës 13 të këtij kreu, hartohet në 2 (dy) kopje, njëra prej të cilave duhet të mbahet në bord e tjetra në selinë zyrtare të operatorit të turizmit detar.

15. Në rastin e një anijeje me flamur të huaj, përveç dokumenteve sipas pikës 12, të këtij kreu, duhet të mbajë në bord edhe licencën e kategorisë VII.4.1.

16. Një shtetas i huaj, anëtar i ekuipazhit të një mjeti lundruar, sipas pikës 5, të këtij kreu, duhet të respektojë legjislacionin në fuqi që rregullon qëndrimin e punën e të huajve në Republikën e Shqipërisë.

17. Një individ i huaj, që disponon një dëshmi të huaj për drejtimin e mjeteve lundruar të vogla, mund të drejtojë, përkohësisht, një mjet lundruar turistik shqiptar me kapacitet deri në 12 (dymbëdhjetë) persona, përfshirë drejtuesin, për qëllime turistike dhe argëtimi. Në këtë rast, operatori i turizmit detar njofton kapitanerinë e portit. Në rastin kur mjeti ka kapacitet mbi 12 (dymbëdhjetë) pasagjerë, individit duhet të marrë një njohje paraprake të kualifikimeve nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

18. Me përjashtim të rasteve kur qiradhënësi jep pëlqimin e tij, kontrata nuk konsiderohet e rinovuar, pavarësisht se me përfundimin e afatit të caktuar qiramarrësi ruan të drejtën e mbajtjes së mjetit lundruar të kontraktuar më parë dhe detyrimin e dorëzimit të mjetit në gjendjen fillestare, pavarësisht kalimit të afatit të kontratës.

19. Përveç dëshirës së ndryshme të palëve, në rast të vonesës së dorëzimit nga ana e qiramarrësit të mjetit lundruar, për një periudhë që nuk e kalon një të dhjetën e kohëzgjatjes së kontratës së nënshkruar më parë, atëherë vonesa nuk përbën detyrim për likuidim dëmsh, por qiradhënësit, për periudhën e kohës që del jashtë zgjatjes së kontratës, i jepet nga ana e qiramarrësit një masë shpërblimi për ditët e tejkaluara sa dyfishi i tarifës ditore të qirasë të vendosur në kontratë.

20. Të drejtat që rrjedhin nga kontrata e qirasë shfuqizohen me kalimin e një viti. Periudha fillon nga data e përfundimit të kontratës ose, në rastin e përmendur në pikën 18, të këtij kreu, nga data e dorëzimit të mjetit.

21. Operatori i turizmit detar ka detyrim të dorëzojë mjetin lundrues turistik me pajisjet përkatëse, në gjendje normale pune, të kompletuar me të gjitha pajisjet e sigurisë, me dokumentet e nevojshme për lundrim dhe të mbuluar nga siguracioni përkatës për mbulimin e dëmeve ndaj palëve të treta (edhe ndaj personave në bord).

22. Qiramarrësi (klienti) duhet të përdorë mjetin për argëtim, sipas karakteristikave teknike të përcaktuara në licencën e lundrimit, në përputhje me qëllimet e lundrimit turistik e ta dorëzojë në gjendjen fillestare pa dëmtime.

23. Të gjitha mjetet lundruese për argëtim, me gjatësi mbi 24 (njëzet e katër) metra janë të detyruara të instalojnë një aparat marrës-transmetues në radiofoni, me valë etometrike, sipas normave të përcaktuara nga autoritetet kompetente dhe një pajisje gjurmimi *Automatic Identification System* (në vijim "AIS").

24. Të gjitha mjetet lundruese për argëtim, me gjatësi të barabartë ose më të vogël se 24 (njëzet e katër) metra, që lundrojnë në distancë mbi 6 (gjashtë) milje nga bregu, duhet të pajisen me të paktën një aparat transmetues me valë metrike (VHF), që mund të jetë edhe i lëvizshëm, sipas normave të përcaktuara nga autoritetet kompetente dhe një pajisje gjurmimi AIS.

25. Për anijet dhe barkat për argëtim, që lundrojnë në distancën mbi 12 (dymbëdhjetë) milje nga bregu, është i detyrueshëm instalimi në bord i një pajisjeje gjurmimi AIS, për përcaktimin e vendndodhjes së mjetit lundrues me anë të të dhënave satelitore dhe një radari.

26. Në rastet kur ka manifestime të lundrimeve detare me mjete lundruese për argëtim, të njoftuara më parë nga autoritetet kompetente, të organizuara nga shoqatat e ndryshme detare dhe organizatat kombëtare e ndërkombëtare të njohura nga to, barkat për argëtim të përmasave nga 2.5 (dy pikë pesë) m – 24 (njëzet e katër) m gjatësi, mund të lundrojnë pa limite distancash nga bregu.

27. Për mjetet lundruese për argëtim me gjatësi deri në 2.5 (dy pikë pesë) m, për rastet e manifestimeve, kërkohet leje e veçantë e lëshuar nga autoritetet detare.

28. Për anijet e barkat për argëtim, autoriteti që lëshon lejen për lundrim shënon në këtë leje numrin maksimal të personave që transportohen në bazë të të dhënave të paraqitura në dokumentacionin teknik të paraqitur.

29. Në varësi të gjykimit të kapitenit apo të drejtuesit të mjetit lundrues, shërbimet në bordin e mjeteve lundruese turistike me kapacitet deri në 12 (dymbëdhjetë) pasagjerë, mund të kryhen edhe nga personat në bord, në cilësinë e vizitorit apo të të ftuarit, me kusht që të kenë mbushur moshën 17 (shtatëmbëdhjetë) vjeç për shërbimet e kuvertës, dhomës së gjumit e të kuzhinës, e 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç për shërbimet e makinerisë.

30. Për mjete me kapacitet mbi 12 (dymbëdhjetë) pasagjerë, shërbimet e drejtimit të mjeteve lundruese turistike kryhen nga personel i kualifikuar dhe i autorizuar, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

31. Për mjetet me kapacitet nën 12 (dymbëdhjetë) pasagjerë, shërbime të tjera plotësuese, të bordit, të ambienteve të brendshme dhe të kuzhinës mund të kryhen nga persona, në cilësinë e vizitorit, me kusht që të kenë mbushur moshën 17 (shtatëmbëdhjetë) vjeç.

32. Përgjegjësia civile ndaj palëve të treta, që vjen si pasojë e lundrimit të mjeteve lundruese, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të këtij kreu, parashikohet nga Kodi Civil.

33. Qiramarrësi i mjetit lundrues për argëtim është përgjegjës solidarisht me pronarin. Në rast të zbatimit të qirasë financiare, përdoruesi i mjetit lundrues është përgjegjës solidarisht me drejtuesin e mjetit lundrues, në vend të pronarit.

34. Normat e sigurimit ndaj palëve të treta aplikohen për të gjitha mjetet lundruese turistike parashikuar në legjislacionin për aktivitetet e turizmit detar, me përjashtim të mjeteve lundruese me rrema dhe vela, që nuk janë të pajisura me motor ndihmës.

35. Mjeti lundruar turistik me flamur të huaj mund të lëvizë, të qëndrojë dhe të lundrojë pa kufizim në ujërat e brendshme në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë për një periudhë jo më shumë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj pas marrjes së njoftimit nga kapitaneria e porteve.

36. Mjeti lundruar që përdoret për qëllime tregtare, sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij kreu, është i detyruar të jetë i pajisur minimalisht me internet nëpërmjet një pajisjeje *smartphone*.

II. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË ZHYTJEVE ÇLODHËSE DHE PESHKIMIT NËN UJË

1. Qëllimi i këtij kreu është përcaktimi i rregullave, të cilave u nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë, të certifikuar si operatorë të turizmit detar, që kërkojnë të ushtrojnë aktivitetin e zhytjeve çlodhëse, të peshkimit nën ujë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe personat që marrin pjesë në zhytjen çlodhëse, për të maksimizuar sigurinë gjatë zhytjes çlodhëse.

2. Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime.

a) “Zhytje” përdoret vetëm për zhytjet çlodhëse. Zhytësit që e zhvillojnë këtë veprimtari për qëllime sportive dhe ushtarake nuk do t’i përmbahen këtij kreu, përveçse kur marrin pjesë në aktivitete të zhytjes çlodhëse.

b) “Drejtues zhytjeje” udhërrëfyesi turistik i interesit të veçantë “zhytje”, certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas legjislacionit në fuqi, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen, organizimin e zhytjeve dhe drejtimin e zhytësve amatorë ose profesionistë, sipas kërkesës së operatorit të turizmit detar.

c) “Grup” dy ose më shumë persona, të drejtuar nga një drejtues zhytjesh, të cilët marrin shërbimet e zhytjes çlodhëse nga qendra e zhytjeve.

ç) “Zhytje e organizuar”, shërbim i organizuar, ofruar nga operatori i turizmit detar, për klientët profesionistë, sipas përcaktimeve të këtij kreu.

d) “Zhytje e shoqëruar”, shërbim i organizuar, i ofruar nga operatori i turizmit detar, për klientët amatorë, sipas përcaktimeve të këtij kreu.

dh) “Klient profesionist”, personi që ka përfunduar në mënyrë të pavarur një kurs trajnimi të një agjencie trajnuese të njohur, sipas aneksit B, që zotëron një certifikatë të lëshuar prej tyre me nivele klasifikimi zhytjeje sipas aneksit C, një certifikatë të vlefshme mjekësore se është i aftë të kryejë zhytje dhe kërkon shërbime pranë një qendre zhytjeje.

e) “Qendra e zhytjes”, veprimtari e zhytjes çlodhëse që ushtrohet nga operatori turistik detar, i cili ofron shërbime, sipas kritereve të përcaktuara në këtë krye.

ë) “Agjenci trajnuese e njohur”, subjekt që ofron sisteme dhe certifikata trajnimi për zhytjen nënujore çlodhëse dhe që është përgjegjëse për zbatimin e menaxhimin e cilësisë për trajnimin e zhytjes nënujore, e njohur nga Këshilli Botëror i Trajnimeve për Zhytjet e Rekreative (WRSTC).

f) “Klient amator”, personi që nuk ka ndonjë kualifikim lidhur me aktivitetin e zhytjes e zotëron një certifikatë të vlefshme mjekësore se është i aftë të kryejë zhytje dhe kërkon shërbime pranë një qendre zhytjeje.

g) “Mjedis ujor i hapur”, hapësirë ujore shumë më e madhe se një pishinë, që ofron kushte të ngjashme të një hapësire natyrore ujore që haset nga zhytësit në lidhje me shikueshmërinë, thellësinë, lëvizjen e ujit e hyrjen në të.

gj) “Mjedis ujor i kufizuar”, një pishinë me një thellësi maksimale 5 (pesë) m ose një hapësirë ujore, që ofron kushte të ngjashme të një hapësire natyrore ujore që haset nga zhytësit, në lidhje me shikueshmërinë, thellësinë, lëvizjen e ujit e hyrjen në të.

h) “Vlerësim rreziku”, identifikimi i rreziqeve gjatë zhytjes dhe cili mund të dëmtohet prej tyre, me qëllim që të adaptohen procedurat për të siguruar minimizimin e rrezikut;

i) “Gaz frymëmarrjeje”, përzierje e gazeve inerte me oksigjenin, që do të prodhojnë në thellësinë operationale maksimale një presion të pjesshëm të oksigjenit që nuk i kalon 1.6 (një pikë gjashtë) bar.

3. Qendra e zhytjes, në funksion të ushtrimit të aktivitetit të operatorit turistik, ofron shërbimet e mëposhtme:

- a) zhytjen e organizuar e të shoqëruar për zhytësit;
- b) dhënien me qira të pajisjeve të zhytjes nënujore;
- c) furnizimin e zhytësve me gaz për frymëmarrje.

4. Ushtrimi i aktivitetit të zhytjes çlodhëse kryhet vetëm nga operatori i turizmit detar, i licencuar si operator turistik me licencën me kodin XIII.1.B “Operator turistik”, dhe i certifikuar nga ministri përgjegjës për turizmin. Ai duhet:

- a) të ushtrojë aktivitetin e tij në vende të lejuara, sipas zonave të publikuara nga ministria përgjegjëse për turizmin;
- b) të ketë policë sigurimi, që mbulon përgjegjësinë ndaj palëve të treta, sipas legjislacionit për turizmin;
- c) të ketë një kontratë punësimi ose kontratë shërbimi me një drejtues zhytjeje të certifikuar si udhërrëfyes turistik i interesit të veçantë “zhytje”, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Drejtuesi i zhytjeve është përgjegjës, për:

- a) hartimin e planit ditor të qendrës për zhvillimin e zhytjeve;
- b) kontrollin e mbikëqyrjen e veprimtarisë së personelit të qendrës;
- c) administrimin e të dhënave të personave që marrin pjesë në zhytje;
- ç) mbajtjen e kontakteve me rojën bregdetare, me shërbimet e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore dhe Policinë e Shtetit;
- d) administrimin dhe ruajtjen e regjistrit të personelit edhe një vit pas largimit të personit të punësuar me këto të dhëna:

- i. emri, adresa dhe data e lindjes;
- ii. trajnimi/certifikimi, eksperiencia;
- iii. certifikimi mjekësor;

dh) administrimin e ruajtjen e regjistrit të klientit, për jo më pak se një vit, me të dhënat, si më poshtë vijon:

- i. emri, adresa dhe data e lindjes;
- ii. deklaratat mjekësore (aneksi A) dhe kontrolli mjekësor, sipas rastit, të firmosura nga prindi ose kujdestari ligjor në rastin e të miturve;
- iii. çdo eksperiencë, trajnim/certifikatë e mëparshme;
- iv. kopje e aprovimit për të marrë pjesë në aktivitetet e zhytjes nga prindi ose kujdestari ligjor i të miturit;

e) administrimin e ruajtjen e të dhënave për jo më pak se 1 (një) vit nga organizimi, për çdo zhytje në mjedis ujor të kufizuar ose të hapur, duke përfshirë emrat e klientëve, personelin/anëtarët e qendrës që asistojnë klientët, vendin e zhytjes, datën, kohën e hyrjes e të daljes, thellësinë, gazin e përdorur, kushtet e erës dhe të detit. Ky dokument mund të përdoret si një pjesë e vlerësimit të rrezikut;

ë) administrimin dhe ruajtjen e të dhënave për klientët që kanë lidhur kontratë qiraje për pajisjet, të paktën për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh.

6. Të gjithë klientëve, para ofrimit të shërbimeve të zhytjes çlodhëse, duhet t’u jepet detyrimisht informacioni i mëposhtëm:

- a) licenca si operator turistik, certifikata si operator i turizmit detar për ushtrimin e aktivitetit të zhytjes çlodhëse;
- b) parakushtet e kërkesat thelbësore që duhet të përmbushë klienti, me qëllim që të përftohet shërbimi (aneksi A);
- c) tarifat e polica e sigurimit që disponon qendra në rast aksidentesh;
- ç) informacion për mjedisin ku do të kryhen zhytjet, legjislacionin në lidhje me zhytjet e kërkesat ligjore lidhur me llojin specifik të shërbimit.

7. Nëse shërbimi i dhënë është zhytje e shoqëruar ose e organizuar, klientëve duhet t’u ofrohet edhe informacioni i mëposhtëm, përveç atij të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, për:

a) vendin ku do të zhvillohet zhytja, veçanërisht rreziqet që mund të ndikojnë në sigurinë e zhytjes (p.sh., pengesat nënujore);

b) madhësinë e grupit dhe organizimin e tij;

c) rregullat e sigurisë, kufijtë e thellësisë, karakteristikat e zhytjes, rrymat e kushtet mjedisore;

ç) informacion në lidhje me burimet më të afërta mjekësore (duke përfshirë të dhënat lidhur me disponibilitetin e një dhome dekompressioni dhe ose rekompressioni).

8. Para ofrimit të shërbimit të zhytjes, të gjithë zhytësit duhet të lexojnë dhe të nënshkruajnë një pyetësor të përshtatshëm mjekësor, sipas aneksit A bashkëlidhur. Nëse përgjigjet në pyetësor tregojnë një rrezik mjekësor, klienti kalon në një vizitë të plotë mjekësore nga një mjek i specializuar, i cili duhet të japë aprovimin e tij para se të bëhet zhytja. Megjithatë:

a) pavarësisht përgjigjeve të pyetësorit, në çdo rast dyshimi, qendra mund t'i referojë klientit shërbimet e përshtatshme mjekësore;

b) qendra e zhytjes duhet të mbajë një regjistër të deklarimeve mjekësore dhe të kontrolleve, sipas rastit;

c) nëse një klient bëhet i ndërgjegjshëm për një ndryshim në gjendjen e tij mjekësore, procesi i kontrollit duhet të përsëritet në çdo kohë.

9. Para çdo shërbimi zhytjeje, klientëve u bëhen të ditura procedurat e rëndësishme të sigurisë:

a) identiteti dhe funksionet e personelit;

b) procedurat e emergjencës;

c) shoku dhe grupi i zhytjes;

ç) normat e sjelljes të kërkuara prej klientëve.

10. Për të gjitha vendndodhjet ku kryhen aktivitete zhytjeje, qendra siguron që të jenë të disponueshme sa më poshtë:

a) një set i ndihmës së shpejtë për aktivitetin e zhytjes së planifikuar;

b) një njësi emergjence oksigjeni me një kapacitet furnizimi prej të pakën 15 (pesëmbëdhjetë) litra/min, me oksigjen të pastër për të paktën 20 (njëzet) minuta;

c) një sistem komunikimi të përshtatshëm për të njoftuar shërbimet e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.

11. Ofrimi i shërbimit të dhënies me qira të pajisjeve të zhytjes për klientët për aktivitetet e zhytjes së mbikëqyrur dhe të pambikëqyrur duhet të kryhet në përputhje me sa më poshtë:

a) me përjashtim të maskës, lopatave të zhytjes, tubit për frymëmarrje dhe veshjes së lagur, dhënia me qira e të gjitha pajisjeve të tjera është e kufizuar për klientët amatorë;

b) dhënia e pajisjeve nga klienti një pale të tretë është e ndaluar;

c) dhënësit e shërbimit sigurojnë që personeli i tyre është i kualifikuar për të këshilluar klientët në lidhje me përshtatshmërinë dhe përdorimin e duhur të pajisjeve të zhytjes në aktivitete specifike zhytjeje, duke marrë parasysh llojin e aktivitetit të zhytjes së planifikuar, kualifikimet e nevojat e klientit (p.sh., përshtatshmëria e mjeteve të kontrollit të pluskimit e të veshjeve);

ç) pajisjet e zhytjes, që u jepen me qira klientëve, i nënshtrohen një inspektimi nga dhënësi i shërbimit para dhënies, me qëllim që të konfirmohet se është plotësisht operacional.

12. Shitja e gazeve për frymëmarrje duhet të kryhet në përputhje me sa më poshtë:

a) u ofrohet klientëve të kualifikuar të paktën sipas përcaktimeve të këtij kreu për “klient profesionist”;

b) në rastin kur ofrohet gaz për frymëmarrje, i ndryshëm nga ajri i kompresuar, ky ofrohet vetëm për ata klientë që kanë kualifikimet e përshtatshme shtesë;

c) mbushja e bombolave lejohet vetëm për ato pajisje të prodhuara në 4 (katër) vjetët e fundit, sipas shënimit në kartelën shoqëruese të saj apo që pas katër vjetësh i janë nënshtruar një procedure kolaudimi çdo 2 (dy) vjet apo që janë kolauduar në 6 (gjashtë) muajt e fundit për shtypjen hidrostatike, të kryer nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara për këtë qëllim, në përputhje me vendimin nr. 78, datë 28.1.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve nën presion”;

ç) nëse pas inspektimit të jashtëm të cilindrit lind dyshimi, në lidhje me gjendjen e tij ose vlefshmërinë e shenjave ose pastërtinë e oksigjenit, qendra ka të drejtën të refuzojë mbushjen e cilindrit;

d) furnizimi i gazeve për frymëmarrje nga një klient për një palë të tretë nuk lejohej;

13. Në çdo rast të prodhimit të gazit, në qendrën e zhytjes ose nga një palë e tretë, prodhimi bëhet në përputhje me sa më poshtë:

a) kompresorët e prodhimit të gazit për frymëmarrje të jenë të markuara me markën CE, në përputhje me standardet në fuqi, në nivel kombëtar dhe/ose evropian dhe të publikuara nga organizmat kombëtarë dhe evropianë të standardizimit, të harmonizuara për prodhimin e ajrit për frymëmarrje me përmbajtje të ajrit sipas standardit EN 12021;

b) sistemet e kompresorit, të mbajtjes, të shpërndarjes, të përzierjes e të mbushjes së gazit instalohen dhe mirëmbahen, sipas standardeve të parashikuara nga prodhuesi, sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore e në përputhje me një grafik kohor me shkrim të parapërgatitur nga qendra e zhytjes ose prodhuesi i gazit;

c) përzierja e gazit kryhet nga personat që kanë përfunduar me sukses një kurs për përzierjen e gazit dhe të jenë certifikuar pranë një trupe certifikuese të akredituar;

ç) ajri që përdoret për të furnizuar me gaz zhytësit duhet t'i nënshtrohet një testi për pastërtinë e tij, 2 (dy) herë në vit, nga një laborator i akredituar, në muajin prill dhe në muajin gusht, duke e shoqëruar këtë proces me lëshimin e një certifikate përputhshmërie me standardet kombëtare dhe/ose evropiane, të publikuara nga organizmat kombëtarë dhe evropianë të standardizimit, sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;

d) qendra ose pala e tretë administrojnë dhe ruajnë për 30 (tridhjetë) ditë një regjistër me të dhënat për të gjitha bombolat që mbushen me gaz për frymëmarrje, të ndryshëm nga ajri, duke përfshirë datën, numrin e referencës së cilindrit, përzierjen e matur, thellësinë maksimale përkatëse të operimit e nënshkrimet e klientit dhe të përzierësit.

14. Të gjitha pajisjet e zhytjes që përdoren për zhytje çlodhëse duhet të jenë prodhuara sipas standardeve kombëtare dhe/ose evropiane, të publikuara nga organizmat kombëtarë dhe evropianë të standardizimit dhe u nënshtrohen shërbimeve dhe mirëmbajtjes, sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe specifikimeve të prodhuesve, sipas një grafiku të parapërgatitur nga qendra e zhytjes, ku identifikon të gjitha bombolat individuale, si dhe burimet alternative për gazin e frymëmarrjes, sistemet e mbështetjes së cilindrit dhe mjetet e kontrollit të pluskimit, sistemet e rifrymëmarrjes dhe setet e administrimit të oksigjenit.

15. Përgjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, qendra e zhytjes, si pjesë e aktivitetit të operatorit turistik, duhet të sigurojë inventarin e pajisjeve, si më poshtë vijon:

a) çantë e ndihmës së shpejtë;

b) oksigjen (O_2) dhe depozitë e furnizimit me O_2 ;

c) mjete të komunikimit (telefon fiks, VHF, CB ose GSM);

ç) tabelë ku shfaqen numrat e telefonit të dhomave të rekompresimit dhe dekompresimit, në rastet e aksidenteve ose të emergjencave;

d) mjet për transportin e viktimave të incidenteve;

dh) pajisje për zhytje, bashkëkohore dhe funksionale;

e) shërbimi i kompresorëve duhet të jetë funksional dhe me një kapacitet prej të paktën 180 (njëqind e tetëdhjetë) l/min;

ë) pajisje që nevojiten për të shënuar hapësirën e zhvillimit të aktivitetit (flamuj zhytjeje, drita për zhytje natën etj.), sipas standardeve të përcaktuara në këtë krye.

16. Drejtuesi i zhytjes kryen një vlerësim të rrezikut në të gjitha vendet e zhytjes, ku realizohet zhytje e shoqëruar ose e organizuar për klientët, duke shqyrtuar faktorët e mëposhtëm:

a) lëvizjen e ujit;

b) thellësinë;

- c) shikueshmërinë nën ujë;
- ç) ndotjen;
- d) metodat e hyrjes/daljes;
- dh) zonat ku nuk lejohet zhytja;
- e) përshtatshmërinë e vendit për aktivitetet e planifikuara;
- ë) planin e veprimit për emergjencat e, në vlerësim të rrezikut, kur mendohet të jetë në interesin e lartë të klientit dhe/ose të klientëve të tjerë, drejtuesi i zhytjes ndalon çdo klient të marrë pjesë në aktivitet, ndërkohë që të gjitha detajet e vlerësimit të tij ua bën me dije zhytësve para nisjes së zhytjes.

17. Zhytjet çlodhëse u nënshtrohen detyrimeve të mëposhtme:

- a) thellësia maksimale për të gjithë zhytësit është 40 (dyzet) m;
- b) zhytësi amator mund të zhytet në një thellësi prej 12 (dymbëdhjetë) m ose brenda limiteve të përcaktuara nga standardet e agjencisë ndërkombëtare që ka kryer certifikimin e tij, por jo më shumë se 20 (njëzet) m, pavarësisht se po zhytet nën mbikëqyrjen e një udhërrëfyesi turistik të certifikuar;
- c) pas çdo zhytjeje, që nuk e ka tejkaluar kohën e zhytjes, duhet të bëhet një ndalesë sigurie në dalje, në thellësi 5 (pesë) m për të paktën 3 (tre) min;
- ç) për sigurinë e tyre, zhytësit duhet të fillojnë daljen me një presion rezervë jo më pak se 50 (pesëdhjetë) bar;
- d) përdorimi i pajisjes shtytëse të kontrollit (*buoyancy control device*) është absolutisht i detyrueshëm për të gjitha aktivitetet e zhytjes;
- dh) një zhytës i vetëm nuk lejohet në zhytje në asnjë rrethanë;
- e) seanca familjarizimi me pajisjet e oksigjenit duhet të sigurohen nga qendra e zhytjeve për të gjithë stafin zhytës dhe ky trajnim duhet të mbahet të paktën çdo vit.

18. Ofrimi i zhytjeve çlodhëse të organizuara ose të shoqëruara u nënshtrohet detyrimeve të mëposhtme:

- a) u ofrohen vetëm klientëve, të cilët janë të kualifikuar si “klient profesionist” ose “klient amator”, sipas përcaktimeve të shkronjave “dh” e “P”, të pikës 2, të këtij kreu, dhe udhëhiqen nga drejtuesi i zhytjes, i certifikuar si udhërrëfyesi turistik i specialitetit të veçantë “zhytje” nga ministria përgjegjëse për turizmin;
- b) organizohen e udhëhiqen nga një zhytës që ka kualifikime shtesë përtej kualifikimeve të një drejtuesi zhytjeje, në rastet e veçanta:
 - i. të zhytjes natën;
 - ii. të zhytjes me shikueshmëri të kufizuar;
 - iii. të zhytjes në thellësi;
 - iv. të zhytjes në anije të mbytura
 - v. të zhytjes me veshje të thatë;
 - vi. të zhytjes në rrymë;
 - vii. të zhytjes në guva.

19. Procesi i mbikëqyrjes së të gjitha aktiviteteve të zhytjeve çlodhëse të organizuar nga një qendër zhytjeje, si “zhytje të shoqëruara”, është i detyrueshëm dhe u nënshtrohet kërkesave të mëposhtme:

- a) ushtrohet “mbikëqyrje e drejtpërdrejtë” me praninë fizike të stafit të qendrës së zhytjes, ku, gjatë organizimit të aktiviteteve të zhytjes, vlerësohet sjellja personale e çdo zhytësi dhe parandalimi ose korrigjimi i problemeve kur ato ndodhin;
- b) ushtrohet “mbikëqyrje e tërthortë” me praninë fizike të stafit të qendrës së zhytjes gjatë organizimit, i cili është në dispozicion për t’iu përgjigjur problemeve kur ato ndodhin;
- c) klienti profesionist, i cili nuk ka aftësi ose përvojë për t’u zhytur në mënyrë të sigurt e të qetë në kushte të caktuara të mjedisit, duhet të zhytet nën mbikëqyrjen e drejtuesit të zhytjes;
- ç) në rast se qendra nuk ushtron procesin e mbikëqyrjes, bëhet subjekt i rishikimit të certifikatës së operatorit të turizmit detar.

20. Gjatë ushtrimit të aktiviteteve të zhytjes çlodhëse, zhytësit duhet të jenë të pajisur me:

- a) maskë, tub ajri, lopata për këmbët;
- b) rregullator matës të presionit gjatë zhytjes e burime alternative të ajrit ose furnizues ajri;
- c) kompresor për shtytjen e ajrit, jelek me inflator oral e me inflator të ulët presioni;
- ç) pajisje për matjen e kohës e të thellësisë;
- d) kompjuter zhytjeje, që janë të rekomanduar për të gjithë zhytësit;
- dh) pajisje emergjente sinjalizimi në sipërfaqe, si: bilbil e tullumbace të mbushura me ajër.

21. Gjatë ushtrimit të aktiviteteve të zhytjes çlodhëse gjatë natës, zhytësit duhet të jenë të pajisur edhe me:

- a) fener nënujor e pajisje sinjalizuese;
- b) shënues uji, i cili krijon sipërfaqe reflektuese.

22. Drejtuesi i zhytjes duhet të jetë i pajisur me thikë dhe pajisje sinjalizuese emergjente.

23. Anija ndihmëse për zhytje, nën përgjegjësinë e një qendre zhytjeje dhe ekuipazhit, u nënshtrohen detyrimeve të mëposhtme:

a) anija e zhytjes duhet të ketë të paktën një ekuipazh prej 3 (tre) vetash, të dedikuar për sigurinë e zhytësve dhe mbështetës të tyre në çdo mënyrë të mundshme, ku të paktën një person qëndron gjithmonë në sipërfaqe gjatë zhvillimit të zhytjes dhe është i aftë të drejtojë/komandojë mjetin lundrues, të ofrojë ndihmën e parë, të aplikojë reanimimin e terpinë me oksigjen, sipas protokolleve të miratuara;

b) anija e zhytjes duhet të jetë në gjendje të komunikojë me qendrën e zhytjes në çdo kohë gjatë zhytjes nëpërmjet një radioje marrëse-dhënëse apo telefonit;

c) anija e zhytjes duhet të ketë lëndë të mjaftueshme djegëse për të bërë udhëtime zhytjeje të paracaktuara vajtje-ardhje dhe për çdo ndryshim të atypëratyshëm të kursit, në rast se kushtet e motit përkeqësohen, duke siguruar kthimin mbrapsht të tyre;

ç) anija e zhytjes duhet të ketë një pajisje rezervë zhytjeje, një set të ndihmës së parë, një pajisje me oksigjen e flamurit e zhytjes dhe një shkallë që lejon dalje të kollajshme nga uji;

d) anija e zhytjes gjithmonë duhet të shfaqë sinjale për të informuar përdoruesit e anijeve të tjera për praninë e zhytësit nëpërmjet flamurit ndërkombëtar “A”, me ngjyra të bardhë e blu, me përmasa të paktën 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) mm i gjatë dhe 600 (gjashtëqind) mm i gjerë.

dh) anija e zhytjes duhet të mbajë në bord një dritë kërkimi operacionale për të gjitha zhytjet gjatë natës.

24. Klienti amator, në mungesë të të provuarit të paktën të 30 (tridhjetë) zhytjeve apo kur në 3 (tre) muajt e fundit nuk është kryer zhytje, është i nevojshëm të kryejë procesin e orientimit të zhytjeve, në ujë të cekët në qetësi, në kushte të kontrolluara, ku zhytësit i jepet mundësia për të rifituar besimin në aftësitë e tij/saj, duke përfshirë, por jo kufizuar në:

- a) pastrimin e maskës;
- b) rikuperimin e rregullatorit;
- c) shtytësin e neutralizuar;
- ç) ngjitje, zbritje;
- d) burimet alternative të frymëmarrjes me ajër.

25. Për të siguruar shmangien e rreziqeve përgjatë aktivitetit të zhytjeve, ndalohen:

- a) zhytjet e dekompresuara;
- b) zhytjet në thellësi më të mëdha se 40 (dyzet) m;
- c) zhytjet në më pak se 24 (njëzet e katër) orë përpara fluturimit;
- ç) zhytjet në zona të ndaluara.

25. Për të siguruar mbrojtjen e pasurisë kulturore nënujore përgjatë zhytjeve pranë rrënojave dhe artefakteve nënujore, duhet që:

a) procesi i zhytjes të kryhet me kujdes për të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund të çojë në dëmtimin e tyre;

b) të gjithë personat që zhyten duhet të respektojnë legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe konventën evropiane “Për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike” (e rishikuar);

c) në rast se, si pasojë e aktivitetit të zhytjes, gjendet një pasuri kulturore detare, të deklarohet gjetja e saj pranë autoritetit portual më të afërt brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga zbulimi apo mbarëritja në portin e parë. Autoriteti portual njofton menjëherë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, me përgjegjësi administrimi të zonës ku ndodhet porti, dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore;

ç) personi që zbulon një pasuri kulturore nënujore është i detyruar të mos e lëvizë atë nga vendi i zbulimit, ta ruajë dhe të mos e dëmtojë atë;

Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

27. Për të siguruar mbrojtjen e mjedisit ujor përgjatë procesit të zhytjeve, duhet që:

a) zhytësi të sigurojë një njohje paraprake për organizmat e gjallë dhe habitatet në mjedisin detar e të informohet nga instruktori për qëndrimin që duhet të mbajë gjatë veprimtarisë së zhytjes, si kontrolli, duke shmangur dëmtimin e kontaktin fizik me kafshë detare;

b) zhytësi, gjatë zhytjes, të mos përdorë në asnjë rrethanë ushqim peshkaqeni;

c) zhytësi ndalohet të ushtrojë aktivitete të dëmshme për zonat e mbrojtura detare, speciet e mbrojtura dhe habitatet e tyre, sipas legjislacionit për mjedisin e zonat e mbrojtura;

ç) zhytësi të sigurojë leje nga ana e autoriteteve përkatëse që kanë në administrim zonat e mbrojtura për t'u zhytur në zonat e mbrojtura.

28. Për të ushtruar aktivitetin e peshkimit nën ujë, duhet që:

a) zhytësi të mos gjuajë disa lloje peshqish në periudha e zona të caktuara, sipas njoftimeve të autoriteteve përgjegjëse;

b) zhytësi të mos zhytet në zonat ekonomike detare, ekskluzive për peshkim;

c) zhytësi për gjueti peshku të mos përdorë përgjatë zhytjes bombola ajri;

ç) zhytësi për gjueti të mos ushtrojë gjuetinë natën nga perëndimi në agim;

d) zhytësi të mos përdorë në asnjë rast pushkët nënujore së bashku me respiratorë nënujorë (autorespirator) njëkohësisht;

e) zhytësi të respektojë të gjitha ndalimet e kufizimet e përcaktuara në legjislacionin që rregullon veprimtarinë e peshkimit.

III. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË KITESURFING-ut

1. Rregullave të këtij kreu u nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë të certifikuar si operatorë të turizmit detar e që kërkojnë të ushtrojnë aktivitetin e *kitesurfing*-ut për qëllime tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe personat që e ushtrojnë individualisht për kënaqësi, për të maksimizuar sigurinë gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti.

2. Operatori i turizmit detar ofron shërbimet e mëposhtme:

a) ture *kitesurfing* të organizuara për një ose më shumë persona;

b) dhënien me qira të pajisjeve për organizimin e tureve *kitesurfing*.

3. Ushtrimi i aktivitetit të *kitesurfing*-ut kryhet vetëm nga operatori i turizmit detar, i licencuar si operator turistik me licencën me kodin XIII.1.B "Operator turistik", dhe i certifikuar nga ministri përgjegjës për turizmin. Ai duhet të ushtrojë aktivitetin e tij brenda zonës së miratuar për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit të turizmit detar nga ministri përgjegjës për turizmin.

4. Operatori i turizmit detar të sigurojë që klientët e tij para se të nisin rrëshqitjen në ujë në kuadër të aktivitetit të *kitesurfing*-ut, të kenë marrë dijeni, të njohin e të familjarizohen me procedurat e vetëshpëtimit, si:

a) duke siguruar sa më shumë që të jetë e mundur shtensionimin e litarëve. Kjo zakonisht do të përfshijë heqjen e të gjithë tensionit nga dy litarët drejtues. Shtensionimi nënkupton zakonisht lëshimin e shiritit të personit që rrëshqet në ujë ose aktivizimin e një mekanizmi shtensionues;

b) duke lidhur litarët lirshëm, për t'u siguruar që tensioni mbetet jashtë litarëve të pasmë e duke lidhur litarin drejtues të mesit mbi shiritin;

c) duke siguruar bordin rrëshqitës (opsionale), personi që rrëshqet e heq atë nga këmbët dhe e siguron në trup, duke i lënë gjymtyrët të lira në ujë. Personi mund të përdorë jelekun mbrojtës të sigurisë për të fiksuar bordin rrëshqitës;

ç) duke drejtuar balonën pranë bregut me ngritjen e njerit krah dhe “lundrimit” në drejtimin e dëshiruar ose me përmbysjen e balonës e uljen në gjunjë;

d) duke mbajtur në konsideratë se litarët e balonës mund të shkaktojnë dëmtime serioze, nëse mbështillen rreth drejtuesit apo fitojnë forcë nga balona, personi që rrëshqet duhet të mundohet të mos ngatërrohet me litarët, duke treguar vëmendje të veçantë për këmbët, nëse është duke rrëshqitur në ujë pas balonës.

5. Operatori i turizmit detar duhet të sigurojë që klientët e tij, para se të nisin rrëshqitjen në ujë në kuadër të aktivitetit të *kitesurfing*-ut, të zbatojnë:

a) kufizimin për nisjen, lëshimin, operimin, fluturimin ose uljen e një balone brenda 45 (dyzet e pesë) m nga një instalim që është mbi nivelin e ujit (kjo vlen për çdo model balone);

b) nisjen e rrëshqitjes në ujë, vetëm kur zotërojnë një zonë të qartë sigurie prej 50 (pesëdhjetë) m, kur rrëshqasin në të njëjtin drejtim me drejtimin e erës dhe një zonë të qartë sigurie prej 30 (tridhjetë) m, kur rrëshqasin në drejtim të kundërt me drejtimin e erës;

c) ndalimin e ushtrimit të *kitesurfing*-ut (rrëshqitjen mbi ujë) në zonat e ndaluara dhe me rrezik, të cilat zakonisht përcaktohen me sinjalistikë dhe, si rrjedhojë, para ndërmarrjes së aktivitetit, subjektet duhet të sigurohen për statusin e tyre. Zonat e ndalimit përfshijnë:

i. zonat e përcaktuara të notit;

ii. zonat e përjashtuara pranë porteve;

iii. kanalet e transportit pranë porteve (mund të kalohen edhe ato, por duhet të sigurohet një pamje e mirë nga anijet e mëdha);

iv. terminalet e trageteve.

6. Operatori i turizmit detar duhet të sigurojë që klientët e tij, në nisje të aktivitetit të *kitesurfing*-ut, të zbatojnë rregullat, si:

a) parimi i së drejtës së përparësisë, e cila përcakton se kush ka “të drejtën e rrugës” dhe kush duhet “të tërhiqet ose të dalë nga rruga”, kur itineraret kryqëzohen;

b) personi që rrëshqet mbi ujë me kurs përpara djathtas ka të drejtën e përparësisë (rrugës);

c) personi që rrëshqet mbi ujë me kurs përpara majtas duhet të tërhiqet, pra, të dalë nga rruga, për t'i lënë përparësinë personit tjetër;

ç) nëse dy persona janë në të njëjtin kurs, personi që rrëshqet në drejtim të kundërt me drejtimin e fryrjes së erës duhet të tërhiqet e t'i japë përparësi personit që rrëshqet në të njëjtin drejtim me fryrjen e erës, për shkak të dinamikës së fortë të lëvizjes së këtij të fundit;

d) nëse dy persona kërkojnë të kalojnë në drejtime të kundërta, personi që do të rrëshqasë në drejtim të kundërt të erës, duhet të fluturojë balonën e tij lart, ndërsa personi që do të rrëshqasë në drejtim të erës, duhet të fluturojë balonën ulët.

7. Operatori i turizmit detar duhet të sigurojë që klienti i tij, përgjatë rrëshqitjes në ujë në kuadër të aktivitetit të *kitesurfing*-ut, të zbatojë rregullat, si:

a) t'i japë përparësi personit që largohet nga bregu (*outgoing*) përkundrejt personit që vjen (*incoming*). Personi afër bregut ose ai që është në përpjekje me valët është më i rrezikuari, kështu që gëzon të drejtën e përparësisë;

b) t'i japë përparësi personit që rrëshqet mbi valë mbi çdokënd tjetër, përveç atij të parashikuar në shkronjën “a”, të kësaj pike;

c) personi që rrëshqet duhet të sigurohet që personi/personat e tjerë kanë marrë dijeni për praninë e tij në ujë dhe kanë njohje për parimin e përparësisë.

8. Në rastin hipotetik të kryqëzimit të balonave përgjatë rrëshqitjes, secili prej personave duhet të lëshojë litarët, pasi balonat e lidhura fitojnë një fuqi të dyfishtë ose litarët gjatë fërkimit mund të këputen, duke krijuar mundësi për ngjarje me pasoja të rënda.

9. Shpejtësia duhet të kufizohet deri në 5 (pesë) nyja brenda 200 (dyqind) m nga vija e bregdetit, 50 (pesëdhjetë) m nga një mol, 50 (pesëdhjetë) m nga një individ, 50 (pesëdhjetë) m

nga një mjet lundrues (i ankoruar ose në udhëtim e sipër) ose nga ndonjë objekt tjetër (përfshirë bovat dhe pilotat) në ujë.

10. Operatori i turizmit detar është i detyruar të pajisë të gjithë klientët, të cilët do të ushtrojnë *kitesurfing*-un, me mjetet e duhura të sigurisë dhe të sigurojë përdorimin e tyre, si më poshtë vijon:

- a) vendosjen e përhershme të një rripi sigurie;
- b) veshjen e një jeleku pluskues shpëtimi, pasi në rrethana përplasjeje, humbja e koshiençës mund të rrezikojë mbytjen;
- c) veshjen e një kokoreje mbrojtëse për të shmangur çdo goditje në kokë;
- ç) pajisjen me fishekzjarrë, për të sinjalizuar vendndodhjen e tij, nëse afër muzgut do të jetë në ujë në kushte jo të favorshme;
- d) pajisjen me një pajisje EPIRB (*Emergency Position Indicating Radio Beacon*) dhe një telefon celular në një çantë të papërshkueshme nga uji, nëse lundron më shumë se 2 (dy) km nga bregu ose në një vend të panjohur, të izoluar;

dh) veshjen e një kostumi uji të përshtatshëm, që nuk krijon vështirësi në lëvizjen e këmbëve dhe të duarve e, kur në vendet e ngrohta, në variantin me krahë dhe këmbë të shkurtra trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) mm, ndërkohë që në vendet e ftohta, në variantin me krahë dhe këmbë të gjata, trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 5 (pesë) mm për të mbrojtur trupin nga temperaturat e ulëta dhe erërat.

e) veshjen e dorezave për shkak të ekspozimit të gjatë në ujë;

ë) veshjen e këpucëve të përshtatshme të ujit në periudhën kur temperatura e ujit është më e ulët se 25 (njëzet e pesë) gradë celsius dhe ajo e ajrit më e ulët se 30 (tridhjetë) gradë celsius, dhe ku terreni është joranorë, duke siguruar mbrojtjen nga i ftohti, lagështia, dëmtimi, për shkak të terrenit dhe qëndrimin e stabilizuar në bord.

f) pajisjen me një mjet të mprehtë për prerjen e litarëve;

g) familjarizimin me mbajtjen e përdorimin e sistemeve të veçanta të sigurisë.

11. Ofruesi i shërbimeve, para nisjes së aktivitetit, duhet të kryejë një kontroll rutinë të sigurisë.

12. Pajisjet e përdorura për mbrojtjen e klientëve, si: jelek pluskues, kokore mbrojtëse, doreza, rrip i sigurisë, këpucë duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për pajisjet e mbrojtjes personale, dhe të standardeve të aplikueshme të harmonizuara shqiptare.

IV. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT WINDSURFING

1. Rregullave të këtij kreu u nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë të certifikuar si operatorë të turizmit detar, që ushtrojnë aktivitetin e *windsurfing*-ut për qëllime tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe personat që ushtrojnë individualisht për kënaqësi, për të maksimizuar sigurinë gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti.

2. Operatori i turizmit detar ofron shërbimet e mëposhtme:

a) ture *windsurfing* të organizuara për një ose më shumë persona;

b) dhënie me qira të pajisjeve për organizimin e tureve *windsurfing*.

3. Ushtrimi i aktivitetit *windsurfing* kryhet vetëm nga operatori i turizmit detar, licencuar si operator turistik me licencën me kodin XIII.1.B “Operator turistik”, dhe i certifikuar nga ministri përgjegjës për turizmin. Ai duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në vende të lejuara, sipas zonave të publikuara nga ministria përgjegjëse për turizmin.

4. Operatori i turizmit detar të sigurojë që klientët e tij, para se të nisin rrëshqitjen në ujë, në kuadër të aktivitetit të *windsurfing*-ut, të kenë marrë dijeni, të njohin dhe të familjarizohen me procedurat e vetëshpëtimit, që përfshijnë:

a) kontrollin e pajisjeve që do të përdoren para nisjes së lundrimit, pasi dëmtimi i tyre mund të sjellë aksidente dhe të rezultojë me pasoja të mundshme:

i. bordi rrëshqitës duhet të kontrollohet për krisje të mundshme;

ii. lidhjet prej gome të pajisjeve duhet të kontrollohen, për shkak të ndikimit të ujit të kripur e diellit;

iii. litarët e pajisjes duhet të kontrollohen rregullisht, për shkak se janë të ekspozuara ndaj abrazivitetit të rërës;

iv. vela së bashku me direkun janë disa elemente, që sigurojnë suksesin ose dështimin e udhëtimit e kontrolli për dëmtimin e tyre është i nevojshëm;

b) njoftimin e operatorit turistik, kur planifikon të realizojë një udhëtim të gjatë, për destinacionin e tij, kohën e kthimit, ndalesat e planifikuara dhe karakteristikat dalluese të mjetit, duke shmangur hyrjen në det pa ndodhur ky komunikim;

c) njohjen e rrymave që krijohen në vendndodhje të ndryshme të territorit detar e fenomenet detare (batica, zbatica), përtej tabelave informuese të vendosura nga autoritetet përgjegjëse;

ç) sigurimin që shërbimet e urgjencës të jenë të pranishme në territor. Sa më gjatë të jetë e nevojshme të pritet për mbërritjen e strukturave përgjegjëse të shpëtimit, aq më shumë ka të ngjarë që personi të zhvendoset nga pozicioni fillestar, nën ndikimin e erës, valëve, rrymave etj. Personi, i cili ushtron aktivitetin *windsurfing* duhet të pajiset nga operatori turistik me numrin e rojës bregdetare para se të ndërmarrë lundrimin;

d) përgatitjen e një vlerësimi të arsyeshëm të rreziqeve, të gjithçkaje që mund të shkojë keq, përfshirë analizimin e valëve, të shkëmbinjve, të rrymave dhe të pikave të mundshme të daljes.

5. Operatori i turizmit detar të sigurojë që klientët e tij, para se të nisin rrëshqitjen në ujë, në kuadër të aktivitetit të *windsurfing*-ut, të zbatojnë kufizimet mbi zonat e lëvizjes, si më poshtë vijon:

a) ndalimin e ushtrimit të *windsurfing*-ut në zonat e ndaluara dhe me rrezik, të cilat zakonisht përcaktohen me sinjalistikë dhe, si rrjedhojë, para ndërmarrjes së aktivitetit, subjektet duhet të sigurohen për statusin e tyre;

b) zonat e ndalimit përfshijnë:

i. zonat e përcaktuara të notit;

ii. zonat e përjashtuara pranë porteve;

iii. kanalet e transportit pranë porteve (mund të kalohen edhe ato, por duhet të sigurohet një pamje e mirë nga anijet e mëdha);

iv. terminalet e traqeteve.

6. Operatori i turizmit detar të sigurojë që klientët e tij, në nisje të aktivitetit *windsurfing*, të zbatojnë:

a) kontrollin e parashikimit të motit nga burimet e njohura para se të nisin lundrimin dhe/ose të marrin informacion për sjelljen e zakonshme të erërave nga popullsia lokale;

b) shmangien e lundrimit:

i. në det të hapur kur erërat fryjnë nga bregu në thellësi të detit;

ii. përgjatë natës, pasi mund të rezultojë një rrezik i panevojshëm;

iii. pasi ka konsumuar pije alkoolike apo substanca të tjera, të cilat mund të reduktojnë reflekset apo aftësinë e tij për të marrë vendime.

7. Operatori i turizmit detar të sigurojë që klientët e tij, përgjatë rrëshqitjes në ujë në kuadër të aktivitetit të *windsurfing*-ut, të zbatojnë:

a) hidratimin e mirë të trupit, duke pirë sasi uji të mjaftueshme, sidomos në ditët me mot të ngrohtë;

b) respektimin e kursit të lëvizjes në ujë, duke synuar shmangien e kryqëzimeve me mjetet e tjera apo shpejtësinë e tyre;

c) krijimin e përparësisë së mjeteve motorike dhe veçanërisht në zonat e ndaluara, ku, sipas rregullave të parandalimit të përplasjes, pajisjet e *windsurfing*-ut konsiderohen si pajisje sportive dhe jo si mjete lundrimi. Respektimi i rregullave përgjatë lundrimit krijon premisat e shkarkimit nga çdo përgjegjësi në rast të ndonjë aksidenti të mundshëm.

8. Operatori i turizmit detar është i detyruar të pajisë të gjithë klientët që do të ushtrojnë *windsurfing* me mjetet e duhura të sigurisë dhe të sigurojë përdorimin e tyre, si më poshtë:

a) vendosjen e përherëshme të një rripi sigurie;

b) veshjen e një jeleku pluskues shpëtimi, pasi në rrethana përplasjeje, humbja e koshiençës mund të rrezikojë mbytjen;

c) veshjen e një kokoreje mbrojtëse për të shmangur çdo goditje në kokë;

ç) pajisjen me fishekzjarrë, për të sinjalizuar vendndodhjen e tij, nëse afër muzgut do të jetë në ujë në kushte jo të favorshme;

d) pajisjen me një pajisje EPIRB (*Emergency Position Indicating Radio Beacon*) dhe një telefon celular në një çantë të papërshkueshme nga uji, nëse lundron më shumë se 2 (dy) km nga bregu ose në një vend të panjohur, të izoluar;

dh) veshjen e një kostumi uji të përshtatshëm, që nuk krijon vështirësi në lëvizjen e këmbëve dhe të duarve e në vendet e ngrohta, në variantin me krahë dhe këmbë të shkurtra, trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) mm, ndërkohë që në vendet e ftohta, në variantin me krahë dhe këmbë të gjata, trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 5 (pesë) mm, për të mbrojtur trupin nga temperaturat e ulëta dhe erërat;

e) veshjen e dorezave, për shkak të ekspozimit të gjatë në ujë;

ë) veshjen e këpucëve të përshtatshme të ujit në periudhën kur temperatura e ujit është më e ulët se 25 (njëzet e pesë) gradë celsius dhe ajo e ajrit më e ulët se 30 (tridhjetë) gradë celsius, dhe ku terreni është joranorë, duke siguruar mbrojtjen nga i ftohti, lagështia, dëmtimi, për shkak të terrenit dhe qëndrimin e stabilizuar në bord;

f) familjarizimin me mbajtjen e përdorimin e sistemeve të veçanta të sigurisë.

9. Personi që ushtron *windsurfing*-un duhet të shmangë çdo manovër në moment të fundit, pavarësisht sinjaleve paralajmëruese. Nëse ndërmerret ndryshimin e kursit apo të shpejtësisë, duhet ta bëjë në kohë, ta bëjë qartë dhe ta bëjë me vendosmëri.

10. Personi që ushtron *windsurfing*-un, në një situatë emergjente, duhet:

a) të vlerësojë nëse rasti më i mirë është të vazhdojë lundrimin apo të presë që situata të kalojë dhe të vazhdojë lundrimin për të dalë në breg. E rëndësishme është që distanca që duhet të përshkojë të jetë e përballueshme; në rast të kundërt;

b) të njoftojë për ndihmë, pa pritur që dikush ta dallojë. Sinjali duhet të jepet e të shihet qartë nëpërmjet një objekti me ngjyra të ndezura.

V. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT ME MOTOR UJI (*JET SKI*)

1. Rregullave të parashikuara në këtë krye u nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë që janë certifikuar si operatorë të turizmit detar, që ushtrojnë aktivitetin e lundrimit me motor uji (*jet ski*) për qëllime tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe personat që ushtrojnë individualisht për kënaqësi, për të maksimizuar sigurinë gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti.

2. Operatori i turizmit detar ofron ture me motor uji (*jet ski*) të organizuara për një ose më shumë persona nëpërmjet dhënies me qera të pajisjeve motor uji.

3. Ushtrimi i aktivitetit të lundrimit me motor uji kryhet vetëm nga operatori i turizmit detar, i licencuar si operator turistik me licencën me kodin XIII.1.B “Operator turistik”, dhe i certifikuar nga ministri përgjegjës për turizmin dhe:

a) aktiviteti duhet të ushtrohet brenda zonës së miratuar për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit të turizmit detar nga ministri përgjegjës për turizmin;

b) mjetet në përdorim të tij duhet të jenë të siguruar pranë shoqërive të sigurimit, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të lundrimit.

4. Operatori i turizmit detar, për të ushtruar aktivitetin e lundrimit me motor uji, paraprkisht duhet të zbatojë kriteret e mëposhtme:

a) moshë minimale e lejuar e një personi për të drejtuar një motor uji (*jet ski*) është 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç;

b) personi që drejton një motor uji (*jet ski*) duhet të jetë i pajisur me lejedrejtimin përkatës të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare;

c) mjetet lundruese në përdorim të tij duhet të jenë me kushte teknike dhe sigurie të përmbushura sipas legjislacionit në fuqi.

5. Operatori i turizmit detar të sigurojë që klientët e tij do të zbatojnë kufizimet që lidhen me distancat e lundrimit dhe të shpejtësisë, si më poshtë vijon:

a) distanca më e afërt e lundrimit me bregun e detit më të afërt është menjëherë pas kufirit të vendosur për notarët, por asnjëherë më e vogël se 300 (treqind) m;

b) distanca më e largët e lundrimit me bregun e detit më të afërt është 1 (një) milje detare;

c) gjatë periudhës prill–nëntor, motorët e ujit (*jet ski*), të cilët lundrojnë deri në 500 (pesëqind) m nga bregu, nuk mund të lundrojnë me shpejtësi më të madhe se 10 (dhjetë) nyja;

ç) gjatë afrimit për ankorim apo parkim në tokë, shpejtësia duhet të ulet në 3 (tri) nyja.

6. Operatori i turizmit detar të sigurojë që klientët e tij do të zbatojnë kufizimet lidhur me zonat e lundrimit e mënyrën e lëvizjes për të minimizuar mundësitë e aksidenteve, si më poshtë:

a) ndalohet lundrimi në rrugëkalimet detare, ngushticat, kanalet e zonat e kufizuara ujore;

b) ndalohet lundrimi gjatë natës e gjatë kushteve të këqija të motit;

c) ndalohet nisja e lundrimit në të njëjtën kohë nga e njëjta pikë me nisjen e një tjetër motori uji;

ç) ndalohet që personi që drejton motorin e ujit (*jet ski*) dhe pasagjerët, gjatë lundrimit, të kryejnë sjellje të gabuara, të cilat kompromentojnë stabilitetin e mjetit;

d) hyrja, dalja, nisja dhe ankorimi i motorit të ujit bëhen vetëm në vendbazimet e mjeteve lundruese dhe në korridoret e lëvizjes së tyre, të portit turistik, të pontilit ose stacionit sezonal të ankorimit, sipas legjislacionit në fuqi. Motori i ujit duhet të qëndrojë brenda një distance prej 1000 (një mijë) m nga njësia bazë (në këtë rast, anija së cilës i përkasin).

7. Operatori turistik zbaton kërkesat e mëposhtme për pajisjen e personave që ushtrojnë aktivitetin e lundrimit me motor uji:

a) veshjen e një jeleku shpëtimi, pasi në rrethana përplasjeje, humbja e koshiencës mund të rrezikojë mbytjen;

b) veshjen e një kokoreje mbrojtëse për të shmangur çdo goditje në kokë;

c) pajisjen me fishekzjarrë, për të sinjalizuar vendndodhjen e tij, nëse afër muzgut do të jetë në ujë në kushte jo të favorshme;

ç) pajisjen me një pajisje EPIRB (*Emergency Position Indicating Radio Beacon*) dhe një telefon celular në një çantë të papërshkueshme nga uji, nëse lundron më shumë se 2 (dy) km nga bregu ose në një vend të panjohur, të izoluar;

d) veshjen e një kostumi uji të përshtatshëm, që nuk krijon vështirësi në lëvizjen e këmbëve dhe të duarve dhe, në vendet e ngrohta, në variantin me krahë dhe këmbë të shkurtra, trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) mm, ndërkohë që në vendet e ftohta, në variantin me krahë dhe këmbë të gjata, trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 5 (pesë) mm për të mbrojtur trupin nga temperaturat e ulëta dhe erërat.

dh) veshjen e dorezave, për shkak të ekspozimit të gjatë në ujë;

e) veshjen e këpucëve të përshtatshme të ujit në periudhën kur temperatura e ujit është më e ulët se 25 (njëzet e pesë) dhe ajo e ajrit më e ulët se 30 (tridhjetë), dhe ku terreni është joranorë, duke siguruar mbrojtjen nga i ftohti, lagështia, dëmtimi, për shkak të terrenit e qëndrimin e stabilizuar në bord;

ë) veshjen e syzeve për t'u mbrojtur nga era dhe uji i kripur; pajisjen me rrip sigurie që vihet në dorë dhe mundëson fikjen automatike të motorit në rast të humbjes së kontrollit të mjetit gjatë lundrimit;

f) pajisjen me bilbil të personave në bord që lejohen sipas prodhuesit të mjetit.

8. Pajisjet e përdorura për mbrojtjen e klientëve, si: jelek pluskues, kokore mbrojtëse, dorezat, rrip i sigurimit, këpucë duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për pajisjet e mbrojtjes personale dhe të standardeve të aplikueshme të harmonizuara shqiptare.

VI. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT WAKEBOARD

1. Rregullave të parashikuara në këtë krye u nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë të certifikuar si operatorë të turizmit detar, që ushtrojnë aktivitetin *wakeboard* për qëllime tregtare në

territorin e Republikës së Shqipërisë dhe personat që ushtrojnë individualisht për kënaqësi, për të maksimizuar sigurinë gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti.

2. Operatori i turizmit detar ofron ture *wakeboard* me mjetet lundruese për një ose më shumë persona.

3. Personi fizik/juridik që kërkon të ushtrojë aktivitetin e *wakeboard*-it ka detyrimin:

a) të ushtrojë aktivitetin e tij brenda zonës së miratuar për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit të turizmit detar, nga ministri përgjegjës për turizmin;

b) që mjetet në përdorim të tij duhet të jenë siguruar pranë shoqërive të sigurimit, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të lundrimit.

4. Operatori i turizmit detar, për të ofruar shërbimet, duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë vijon:

a) të gjitha mjetet lundruese, në kushtet kur në mjedisin ku lundrojnë ndodhen edhe mjete të tjera lundruese, duhet të kenë në bord dy persona. Kjo mundëson që drejtuesi i mjetit lundrues të përqendrohet në procesin e drejtimit, ndërsa personi i dytë është përgjegjës për ndjekjen e të gjitha veprimeve të personit që rrëshqet në ujë dhe transmetimit të sinjaleve (mesazheve) të tij te drejtuesi i mjetit lundrues;

b) personi që drejton mjetin lundrues, që tërheq personin që rrëshqet mbi ujë, duhet të drejtojë mjetin me kujdes e të sigurojë ruajtjen e një distance të arsyeshme nga personat e pronat, në mënyrë që të mos rrezikojë dëmtime në jetën ose pronën e individëve.

5. Operatori i turizmit detar, përgjatë ofrimit të shërbimit, duhet të sigurojë zbatimin e kufizimit lidhur me zonat e lundrimit dhe mënyrën e lëvizjes, për të minimizuar mundësitë e aksidenteve, si më poshtë vijon:

a) ndalohet lundrimi në rrugëkalimet detare, ngushticat, kanalet e në zonat e kufizuara ujore;

b) ndalohet lundrimi gjatë natës një orë pas perëndimit të diellit dhe një orë para lindjes së diellit dhe gjatë kushteve të këqija të motit;

c) ndalohet nisja e lundrimit në të njëjtën kohë nga e njëjta pikë me nisjen e një tjetër mjeti lundrues.

6. Operatori i turizmit detar, para se të nisë ofrimin e shërbimit, duhet që:

a) të kontrollojë që litarët tërheqës të personave në ujë të jenë të padëmtuar për të shmangur çdo përplasje ose aksident;

b) të kontrollojë që platforma rrëshqitëse të jetë e sigurt, pa krisje të thella në trup;

c) të sigurohet që zona ujore të jetë e përshtatshme dhe që nuk cenon veprimtarinë e përdoruesve të tjerë, notarë, pedales e aktivitete të ngjashme.

7. Operatori i turizmit detar, përgjatë ofrimit të shërbimit, duhet të pajisë klientët e tij e të sigurohet, për:

a) vendosjen e përhershme të një rripi sigurie;

b) veshjen e një jeleku pluskues shpëtimi, pasi, në rrethana përplasjeje, humbja e koshiencës mund të rrezikojë mbytjen;

c) veshjen e një kokoreje mbrojtëse për të shmangur çdo goditje në kokë;

ç) veshjen e një kostumi uji të përshtatshëm, që nuk krijon vështirësi në lëvizjen e këmbëve dhe të duarve dhe në vendet e ngrohta, në variantin me krahë dhe këmbë të shkurtra, trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) mm, ndërkohë që në vendet e ftohta, në variantin me krahë dhe këmbë të gjata, trashësia e tij nuk duhet të jetë më e vogël se 5 (pesë) mm, për të mbrojtur trupin nga temperaturat e ulëta dhe erërat;

d) veshjen e dorezave, për shkak të ekspozimit të gjatë në ujë;

dh) vendosjen e syzeve për mbrojtjen nga era dhe uji i kripur;

e) veshjen e këpucëve të përshtatshme të ujit në periudhën kur temperatura e ujit është më e ulët se 25 (njëzet e pesë) gradë celsius dhe ajo e ajrit më e ulët se 30 (tridhjetë) gradë celsius, dhe ku terreni është joranorë, duke siguruar mbrojtjen nga i ftohti, lagështia, dëmtimi, për shkak të terrenit e qëndrimin e stabilizuar në platformën rrëshqitëse.

8. Personi që drejton mjetin lundruar që tërheq personin që rrëshqet mbi ujë, kudo ku është e mundur, sipas kufijve të parashikuar në legjislacion, mund të rrisë shpejtësinë e lundrimit për të mundësuar shijimin e këtij aktiviteti.

9. Operatori turistik duhet të sigurohet që klienti që rrëshqet mbi ujë të dijë notin, por, në mungesë të kësaj, personi që drejton mjetin lundruar duhet të vihet në dijeni për këtë fakt.

10. Operatori turistik, para ofrimit të shërbimit, duhet të sigurojë një seancë njohjeje, ku personat e përfshirë në këtë aktivitet, për të siguruar një komunikim efektiv, dakordësojnë paraprakisht sinjalet e komunikimit.

11. Personi që drejton mjetin lundruar, për të rritur sigurinë, duhet:

a) të nisë lëvizjen e mjetit lundruar vetëm pas sinjalit aprovues të personit që rrëshqet mbi ujë;
b) të mos ndër marrë manovra të forta për të mënjeluar humbjen e kontrollit nga personi që rrëshqet mbi ujë;

c) të mos marrë në bordin e mjetit lundruar personin që rrëshqet mbi ujë, pa fikur më parë motorin e mjetit lundruar.

VII. RREGULLORE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TË *RAFTING*, *KAYAKE* DHE *KANOE*, NË LUMENJ DHE NË UJËRAT E BRENDSHME

1. Rregullave të parashikuara në këtë krye u nënshtrohen të gjithë personat fizikë/juridikë që janë licencuar e certifikuar si operatorë të turizmit detar, që ushtrojnë aktivitetet *rafting*, *kayake* dhe *kanoe* për qëllime tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe personat që ushtrojnë individualisht për kënaqësi, për të maksimizuar sigurinë gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti.

2. Operatori i turizmit detar ofron shërbimet e mëposhtme:

a) ture *rafting*, *kayake* dhe *kanoe* me mjetet lundruar për një ose më shumë persona;

b) dhënie me qira e mjeteve dhe të pajisjeve për ushtrimin e aktiviteteve *kayake* dhe *kanoe*.

3. Ushtrimi i aktiviteteve *rafting*, *kayake* dhe *kanoe* kryhet vetëm nga operatori i turizmit detar, licencuar si operator turistik me licencën me kodin XIII.1.B "Operator turistik" dhe i certifikuar nga ministri përgjegjës për turizmin. Ai duhet të ushtrojë aktivitetin e tij brenda zonës së miratuar për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit të turizmit detar nga ministri përgjegjës për turizmin.

4. *Rafting*-u, për shkak të varësisë nga prurjet e ujit e të nivelit të tyre realizohet në përputhje me regjimin vjetor të tyre.

5. Shërbimet e *rafting*-ut duhet të jenë gjithmonë të planifikuara mirë, të organizuara, të shoqëruara me personel të trajnuar e me të gjitha elementet e nevojshme për të siguruar një praktikim të sigurt të lundrimit dhe të mbrojtjes së mjedisit.

6. Ofruesi shërbimeve të *rafting*-ut duhet:

a) të sigurojë kushtin e personelit të trajnuar, të aftë dhe të certifikuar si udhërrëfyes turistik, sipas legjislacionit në fuqi për të menaxhuar rrethana të rrezikshme, për të realizuar shpëtimin, evakuimin dhe ndihmën e parë, në rastet kur kjo kërkohet në praktikë, si dhe për të siguruar ofrimin e një informacioni të standardizuar sa i përket kulturës, historisë, trashëgimisë dhe pasurive natyrore;

b) të ofrojë të gjitha pajisjet e udhëzimet e nevojshme për klientët, me qëllim praktikimin e sigurt të lundrimit bazuar në rregullat kombëtare dhe në praktikat ndërkombëtare;

c) të hartojë dhe të zbatojë procedurat e nevojshme për të mbajtur në nivel të sigurt pune pajisjet para, gjatë dhe pas lundrimit;

ç) të hartojë dhe të zbatojë procedurat e nevojshme për të ruajtur sigurinë e pjesëmarrësve gjatë kryerjes së lundrimit, si dhe për të reaguar në mënyrën më të mirë përkundrejt një emergjence që mund të ndodhë;

d) të kryejë vlerësimin e rrezikut, të aftësive dhe të kapaciteteve individuale të klientëve të ndryshëm të përfshirë në këtë aktivitet specifik, duke siguruar që të gjithë ata të pajisen në mënyrën e duhur, të dinë të përdorin pajisjet, si dhe të zbatojnë masat e sigurisë;

dh) të përgatisë paraprakisht një plan të përgjithshëm emergjence të përshtatur sipas vendeve specifike të organizmit të lundrimit, duke përditësuar kushtet përpara fillimit të çdo aktiviteti;

e) të informojë stacionin vendor të Policisë së Shtetit, duke informuar në lidhje me përshkrimin, vendndodhjen, pjesëmarrësit, sistemin e komunikimit, kohën e vlerësuar të fillimit e të mbarimit të lundrimit. Pas mbarimit të aktivitetit, në rast se kanë ndodhur probleme me sigurinë gjatë zhvillimit të tij, duhet të njoftohen shërbimet e Policisë së Shtetit;

ë) në përputhje me nivelin e rrezikshmërisë që pritet të shoqërojë pjesëmarrjen në aktivitet, t'u sugjerojë klientëve kryerjen e sigurimit të shëndetit e të jetës në rast aksidenti.

7. Operatori i turizmit detar, në funksion të ofrimit të shërbimeve të parashikuara në këtë krye, duhet të ketë gjithmonë përgjatë ushtrimit të aktiviteti pajisjet e sigurisë, në të cilat përfshihen:

- a) kutia e ndihmës së shpejtë, me material të mjaftueshëm dhe të duhur për aktivitetin sportiv;
- b) paketa/seti i riparimit të mjetit lundrues;
- c) litar shpëtimi rezervë 50 (pesëdhjetë) metra;
- ç) rrema/lopata rezervë.

8. Operatori i turizmi detar, në funksion të ofrimit të shërbimeve të tij, duhet të sigurojë përdorimin e pajisjeve të mëposhtme gjatë lundrimit:

a) helmetë sigurie dhe jelek mbrojtës, sipas tipit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, në përputhje me specifikën e çdo aktiviteti;

- b) kostum neoprene;
- c) këpucë neoprene;
- ç) kostume zhytjeje;
- d) litarë shpëtimi (50 (pesëdhjetë) metra);
- dh) çanta shpëtimi;

e) rrema/lopata për të gjithë pjesëmarrësit;

ë) ganxha shpëtimi të vendosura te jeleku i shpëtimit të udhërrëfyesit;

f) pajisje dhe jelekë shpëtimi, që duhet të shënohen në mënyrë të qëndrueshme me emrin e ofruesit të shërbimeve.

9. Pajisjet e përdorura për mbrojtjen e klientëve, si: jeleku i shpëtimit, helmata e sigurisë, dorezat, ganxha e sigurisë, këpucët, syzet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për pajisjet e mbrojtjen personale dhe standardeve të aplikueshme të harmonizuara shqiptare.

ANEKS A DEKLARATË MJEKËSORE

Për klientin

Duhet të plotësoni këtë deklaratë mjekësore, që përfshin seksionin e informacionit për të dhënat mjekësore të së shkuarës para marrjes së shërbimeve të zhytjes nënujore çlodhëse.

Qëllimi i saj është t'ju informojë nëse ju duhet të vizitoheni nga një mjek para se të merrni pjesë në trajnimin e zhytjes. Çdonjëri prej këtyre kushteve që zbatohet nuk ju skualifikon domosdoshmërisht. Ajo do të thotë vetëm që, për sigurinë tuaj, duhet të kërkonit këshillimin e një mjeku para pjesëmarrjes në zhytjen nënujore.

Jeni të lutur të pranoni që keni lexuar e kuptuar informacionin e dhënë më poshtë, duke vënë inicialet për secilën pikë të veçantë.

| 1. Duhet të konsultoheni me një mjek, nëse: | Po ose Jo | Inicialet |
|--------------------------------------------------------------------------------|------------------|------------------|
| Jeni shtatzënë ose dyshoni që jeni shtatzënë | | |
| Merrni rregullisht ilaçe (me përjashtim të kontrollit të shtatzënisë) | | |
| Jeni mbi 45 vjeç dhe vlejnjë një ose më shumë nga pikat e mëposhtme: | | |
| Pini duhan | | |
| Keni një nivel të lartë kolesterolit | | |
| 2. Duhet të konsultoheni me një mjek, nëse: | Po ose Jo | Inicialet |
| Vuani nga astma, frymëmarrja me vështirësi ose frymëmarrja me vështirësi gjatë | | |

| | | |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
| ushtrimeve | | |
| Çdo formë e sëmundjes së mushkërive | | |
| Pneumotoraks | | |
| Operacione në gjoks në të kaluarën | | |
| Klaustrofobi ose agorafobi (frikë nga hapësirat e mbyllura ose të hapura) | | |
| Epilepsi, ngërç, konvulsione ose marrje e ilaçeve për t'i parandaluar ato | | |
| Humbje e ndjenjave ose e ndërgjegjes në të kaluarën (humbje e plotë ose e pjesshme e ndërgjegjes) | | |
| Aksidente gjatë zhytjes në të kaluarën ose sëmundje nga dekompresioni | | |
| Diabet në të kaluarën | | |
| Presion i lartë gjaku në të shkuarën ose marrje e ilaçeve për të kontrolluar presionin e gjakut | | |
| Sëmundje zemre në të shkuarën | | |
| Sëmundje veshi në të shkuarën, humbje e dëgjimit ose probleme me ekuilibrimin e presionit në vesh. | | |
| Trombozë ose koagulim gjaku në të shkuarën | | |
| Sëmundje psikiatrike | | |

| 3. Jam i ndërgjegjshëm që mund të jem i papërshtatshëm për t'u zhytur, nëse kam ose zhvilloj një nga kushtet e mëposhtme | Iniciale |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Të ftohtë, sinuzit, probleme me frymëmarrjen (p.sh., bronkit, alergji) | |
| Migrenë akute ose dhimbje koke | |
| Çdo lloj operacioni brenda 6 javëve të fundit | |
| Nën ndikimin e alkoolit, të drogës ose të ilaçeve që ndikojnë në aftësinë për të reaguar | |
| Rrufë, marrje mendsh, dobësi, vjellje dhe diarje | |
| Probleme me dëgjimin (oshtimë në veshë) | |
| Ulcerë gastrike akute | |
| Shtatzëni | |

| |
|-------------------------------------------------------------------------------|
| Emri |
| Adresa |
| |
| |
| Datëlindja |
| Konfirmoj që përgjigjet e pyetjeve të mësipërme janë të vërteta dhe të plota. |
| Nënshkrimi, datë |
| Prindi/kujdestari jep pëlqimin nëse pjesëmarrësi është i mitur. |
| Emri i prindit/kujdestarit* |
| Adresa..... |
| Nënshkrimi, datë |
| Kjo deklaratë është e vlefshme për një vit nga data e nënshkrimit. |

ANEKS B
AGJENCI TRAJNUESE TË NJOHURA

Programet edukative të agjencive të mëposhtme për trajnimin e zhytësve njihen si të pranueshme edhe në Republikën e Shqipërisë.

Kjo listë mund të modifikohet herë pas here dhe në çdo rast duhet të bëhet publike.

Të gjitha programet e njohura si ekuivalente nga CMAS-i:

F.I.P.S.A.S. *Italian Federation for Scuba Diving*

FIAS *Associazione Italiana Attivita Subacquee*

| | |
|----------|--------------------------------------------------------------------------|
| V.D.S.T. | <i>German ScubaDiving Federation: Verban Deutscher Sporttaucehr E.V.</i> |
| BSAC | <i>British Sub Aqua Club</i> |
| SAA | <i>Sub Aqua Association</i> |
| ScotSAC | <i>Scottish Sub Aqua Club</i> |
| H.F.U.A. | <i>Hellenic Federation for Underëater Activities and Sportfishing</i> |
| H.R.S. | <i>Hrvatski Ronilacki Savez : Croatia Diving Federation</i> |
| PSS | <i>Professional Scuba Schools</i> |

Të gjitha programet e anëtarëve të RSTC-së në të gjithë botën, duke përfshirë:

| | |
|--------------------------|-------------------------------------------------------|
| PADI - HQ - America | <i>Professional Association of Diving Instructors</i> |
| NAUI - HQ - America | <i>National Association of Underwater Instructors</i> |
| SSI | <i>Scuba Schools International</i> |
| IAC - HQ - Germany | <i>Barakuda International Aquatic Club</i> |
| NASDS - Germany | <i>National Association of Scuba Diving Schools</i> |
| IDD - Holland | <i>Instructor Dive Development</i> |
| PSS | <i>Professional Scuba Schools</i> |
| WASE | |
| <i>Wase DivEducation</i> | |

ANEKS C NIVELET E KUALIFIKIMIT TË ZHYTJES

Kualifikimet e mëposhtme të zhytësit njihen si të pranueshme edhe në Republikën e Shqipërisë:

| | |
|-------|--------------------------|
| BSAC | <i>Sports Diver</i> |
| CMAS | <i>2 1 Star Diver</i> |
| NASDS | <i>Open Water Diver</i> |
| NAUI | <i>Open Water Diver</i> |
| PADI | <i>Open Water Diver</i> |
| SAA | <i>Club Diver</i> |
| SSAC | <i>Third Class Diver</i> |
| SSI | <i>Open Water Diver</i> |
| VDST | <i>Open Water Diver</i> |
| PSS | <i>Open Water Diver</i> |
| WASE | <i>Open Water Diver</i> |